

## **UDHËZIME TE OECD-IOPS MBI LIÇENSIMIN E INSTITUTEVE TË PENSIONIT**

### **I. Përkufizime**

**Liçensë** – Autorizimi i instituteve të pensionit për të vepruar në treg dhe/ose për të pasur të drejtën e përfitimit tatimor. Kërkesat për liçensim mund të zbatohen ose si pjesë e procesit të liçensimit ose nëpërmjet legjislacionit, përputhshmëria me të cilin duhet t'i nënshtrohet një mbikëqyrjeje të vazhdueshme.

**Liçensimi** – Proçesi nga i cili një autoritet i jep lejen një instituti pensioni për të vepruar në treg dhe/ose për të përfituar nga një tatim specifik. Ai përfshin një seri veprimesh, duke përfshirë vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat të veçanta përpara dhënies së lejes për të vepruar në treg dhe/ose lejes për përfitim tatimor, ose mund të përfshijë vlerësimin e statusit të përputhshmërisë me këto kërkesa.

**Instituti i pensionit** – Institut i pavarur juridik me kapacitet juridik dhe që ka përgjegjësi themelore juridike për fondin e pensionit. Ai mund të marrë formën e një instituti të pavarur juridik që vepron si një kujdestar në rastin kur fondi i pensionit është themeluar si një trust, si një shoqëri e administrimit të fondit të pensionit, ose si vetë një fond pensioni kur fondi i pensionit ka kapacitet juridik (p.sh. fondacionet apo shoqëritë kolektive). Një shoqëri sigurimesh ose ndonjë institut tjetër financiar mund të konsiderohet si një institut pensioni nëse ka përgjegjësi juridike të një fondi pensioni ose përputhet me përshkrimin e bërë në fjalinë e parë të këtij përkufizimi. Termi “fond pensioni” nuk i referohet pjesëmarrësve në planin e pensionit, as vetë planit në fjalë, as punëdhënesit (përveç rastit kur punëdhënesi është gjithashtu një shoqëri e administrimit të fondit të pensionit apo ka kontraktuar në mënyrë direkte një shoqëri adminstrimi për t'u marrë me shoqërinë e pensionit).

**Fondi i pensioni** – Një bashkim aktivesh, juridikish të ndara që janë blerë duke kontribuar në një plan pensioni më qëllimin e vetëm të financimit të përfitimeve nga ky plan. Anëtarët e planit/fondit kanë një të drejtë ligjore ose përfitimi ose disa kërkesa të tjera kontraktuale kundrejt aktiveve të fondit të pensionit. Fondet e pensionit mund të marrin formën të një trusti, të një instituti të pavarur me kapacitet juridik (p.sh. fondacion apo shoqëri kolektive), ose të një fondi ligjërisht i shkëputur por pa kapacitet juridik i administruar nga një shoqëri e administrimit të fondit të pensionit ose ndonjë institut tjetër financiar duke vepruar në emër të anëtarëve të planit/fondit. Termi “fond pensioni” nuk i referohet kontratave individuale të pensionit.

**Shoqëria e adminstrimit të fondit të pensionit** – Një tip instituti financiar në formën e një shoqërie që ka si veprimtari të vetme administrimin e fondeve të pensioneve të shkëputura juridikisht. Në disa vende këto institute financiare administrojnë vetëm aktivet e fondit të pensionit. Në disa vende të tjera ato mund të kenë të drejtën edhe për të pagur përfitimet.

**Plan pensioni** – Një kontratë ligjore e detyrueshme e cila ka si qëllim të qartë atë të përfitimit të pensionit (ose – në mënyrë që të përmbushen kushtet në lidhje me taksat ose dispozitat e kontratës – përveç rastit ku përfituesi është më i vjetër se mosha ligjore e daljes në pension, përfitimet nuk mund të paguhen ose do të paguhen vetëm një pjesë pasi të jetë zbritur nga shuma në fjalë një gjobë e konsiderueshme). Kjo kontratë mund të jetë si pjesë e një kontrate më të gjërë punësimi, gjë që mund të përcaktohet në rregullat ose dokumentet e planit të pensionit ose mund të kërkohet me ligj. Përveç qëllimit të qartë për pension, plani mund të ofrojë përfitime të tjera shtesë si ato të invaliditetit, për sëmundje dhe ato për familjarët.

**Trust pensioni** – Një skemë ligjore ku disa individë të caktuar (kujdesatarët) të cilët ruajnë dhe mbajnë pronësi në emër të personave të tjerë (përfituesit). Më konkretisht në fushën e pensioneve, kujdestarët, që mund të jenë një bord individësh ose një shoqëri, veprojnë për interesin e vetëm të anëtarëve të institutit të pensionit dhe përfituesve të tjerë.

**Regjistrimi** – Përfshirja e të dhënave për sa i përket institutit apo planit të pensionet në një regjistër të mbajtur nga autoriteti rregullues dhe/ose mbikëqyrës. Në disa vende regjistrimi është përbërësi i vetëm ose i më rëndësishmi i procesit të autorizimit, përveç disa vlerësimeve që bëhen për kualifikimin e përfitimeve tatimore.

## **II. Parathënie**

### ***Qëllimi***

1. Udhëzimet promovojnë procedura dhe kërkesa për liçensim efikas dhe të paanshëm, duke forcuar kështu konfidencën në sistemin e pensioneve dhe të mbikëqyrjes dhe gjithashtu promovojnë zhvillimin e tregut të pensioneve, ndërsa shmangin pengesa të panevojshme për hyrjen në treg.
2. Udhëzimet gjithashtu parashikojnë një proces liçensimi që është në përputhje me parimet e përcaktuara nga autoritetet rregulluese financiare dhe mbikëqyrëse për të siguruar një koherencë rregullative.
3. Udhëzimet promovojnë synimin e një sistemi liçensues dhe mbikëqyrës për të vendosur dhe për të mbajtur një sistem të fortë të administrimit të fondit të pensionit duke ju kërkuar aplikuesve të instituteve të pensionit të tregojnë që kanë vendosur procedura dhe politika që janë konsistente me një sistem që kërkon të garantojë dhënien e përfitimeve të gjithë anëtarëve të planit të pensionit ashtu siç janë përcaktuar në kushtet e planit dhe në përputhje me bazën ligjore për pensionit.
4. Udhëzimet mbështesin dhe plotësojnë në të njëjtën kohë mbikëqyrjen e vazhdueshme të planeve dhe instituteve të pensionit. Udhëzimet gjithashtu parashikojnë që kriteret për dhënien e liçensës të jenë në përputhje dhe në mbështetje me ato kritere që zbatohen gjatë mbikëqyrjes së vazhdueshme. Në këtë mënyrë procesi i liçensimit shërben

gjithashtu edhe si një mjet rregullues i cili siguron që institutet e pensionit t'i plotësojnë në mënyrë të vazhdueshme kriteret më minimale, edhe pas liçensimit.

5. Udhëzimet plotësohen edhe nga udhëzime të tjera rregullative dhe mbikëqyrese për pensionet të përgatitura nga OECD dhe IOPS, të cilat plotësojnë edhe më shumë kërkesat e përcaktuara në këto udhëzime.

### **Synimi i aplikimit**

6. Këto udhëzime synojnë të zbatohen nga institutet e pensionit të administrura në mënyrë private nga punëdhënësi, që do të thotë një tip instituti, anëtarësimi në të cilat varet nga një marrëdhënie pune – pavarësisht nëse ato janë vullnetare apo të detyrueshme nga ana e punëdhënësve apo punonjësve dhe pavarësisht nëse kontributet përdoren si mjet parësor apo shtesë për financimin e të ardhurave të daljes në pension<sup>1</sup>.

7. Këto udhëzime nuk ju adresohen në mënyrë specifike institutive të tjera të pensionit por megjithatë ato mund të zbatohen edhe nga institute private pensioni. Njëkohësisht, ato mund të jenë të vlefshme edhe për institutet e pensionit në sektorin publik.

8. Këto udhëzime përcaktojnë të gjithë procesin e liçensimit për institutet e pensionit. Aplikimi konkret i këtyre udhëzimeve varet nga struktura e mekanizmave të sigurisë të çdo vendi, nga mënyra se si funksionojnë sistemi i pensioneve dhe politikat e punës në këtë vend dhe gjithashtu varet edhe nga natyra e mbikëqyrjes së vazhdueshme.

9. Në disa vende, ku sistemi i liçensimit të plotë nuk aplikohet që në fillimet e veprimtarisë së instituteve të pensioni, ashtu siç përshkruhet në këto udhëzime, liçensimi mund të limitohet vetëm në autorizimin për qëllime të përfitimit tatimor. Përveç kësaj të fundit, krijimi i një instituti pensioni mund të kërkojë vetëm paraqitjen e disa dokumentave të caktuara pranë autoritetit përkatës dhe regjistrimin e institutit dhe/ose planit të pensionit. Në këtë rast regjistrimi i institutit dhe/ose të planit të pensionit nuk ka nevojë për kryerjen të një proces miratimi nga mbikëqyrësi në bazë të këtyre udhëzimeve. Kjo alternativë në krahasim me procesin e plotë të liçensimit mund të konsiderohet si i përshtatshme duke marrë parasysh sistemin e përgjigjthshëm legjislativ të vendit, mbikëqyrjen ekzistuese të instituteve financiare që merren me administrimin e fondeve/planeve të pensionit dhe gjithashtu varet edhe nga synimi që mund të ketë vendi për të lehtësuar krijimin e planeve të pensionit. Në vendet që i aplikojnë këto parime, është vendimtare që të ekzistojë një sistem legjislativ që është vazhdimisht i efektshëm (duke përfshirë edhe kompensimet në rast të veprimeve të padrejta të kryera nga institutet e pensionit) në mënyrë që të promovojnë një nivel të njëjtë mbrojtjeje me atë nivel mbrojtjeje që mund të arrihej me implementimin e procesit të plotë të autorizimit të përcaktuar në këto udhëzime.

---

<sup>1</sup> Në vendet e BE-së, këto Udhëzime mund të mos zbatohen nga institutet apo planet e pensionit të administrura në mënyrë private nga punëdhënësi nëse janë jashtë qëllimit të Direktivës 2003/41/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 3 qershorit 2003 "Për aktivitetin dhe mbikëqyrjen e insituteve për pensionet profesionale" (Neni 2 i Direktivës).

10. Në mënyrë të njëjtë, kërkesat për një qeverisje të mirë, që janë kushte kryesore të liçensimit, duhet të krijohen edhe për mënyrat alternative të liçensimit me anën e legjislacionit dhe udhëzimeve duke vendosur detyrime mbi ato që drejtojnë institutet e pensionit. Në veçanti, ligji duhet të kërkojë që institutet e pensionit të kenë sisteme kontrolli të njëjtë dhe dokumentacion të saktë ashtu siç mund të kërkohej në një proces të plotë liçensimi, që regjistrimi të mos jetë i mundshëm vetëm nga marrja e këtij informacioni nga instituti i pensionit. Legjislacioni duhet gjithashtu të lejojë anëtarët, të cilët janë prekur në mënyrë të pavaforshme nga veprime të ndryshme, të investigojnë dhe të ankohen për këto veprime, dhe të lejojë që autoriteti mbikëqyrës të investigojë mbi shkeljet e kushteve që zbatohen në procesin e liçensimit. Një nga bazat kryesore të kësaj është që sistemi legjislativ të jetë aq i zhvilluar sa që zbatimi i kërkesave ligjore të kryhet në mënyrë sa më efçente dhe në përputhshmëri me ligjin.

11. Gjatë implementimit të këtyre udhëzimeve duhet të konsiderohet edhe rasti kur një institut pensioni nga një vend ku është liçensuar në mënyrë të rregullt, vendoset në një vend tjetër dhe përfiton nga njohja që i është bërë duke u bazuar në liçensën marrë në vendin e tij<sup>2</sup>.

12. Në rastin kur instituteve financiare u jepet e drejta për të kryer funksionet e drejtimit dhe administrimit, procesi i liçensimit duhet të limitohet deri në verifikimin e atyre çështjeve që nuk janë mbuluar nga mbikëqyrësit e tjerë të institutit financiar. Shembuj të këtyre çështjeve mund të jenë ato në lidhje me kapitalin, qeverisjen dhe dokumentet e qeverisjes, dhe në lidhje me planin e biznesit të përmendura në udhëzimet 6.1, 7.2 and 8.1 dhe paragrafin 7 të Shënimeve.

13. Në rastin kur aplikuesi për liçensë nuk ka filluar akoma të veprojë në treg, disa kërkesa specifike mund të mos jenë të aplikueshme në çastin e aplikimit për liçensë. Shembuj të kësaj natyre mund të jenë menaxhim i riskut, mekanizmat e raportimit të brendshëm dhe të auditimit, dhe raportet e politikave investuese të përmendura në udhëzimet 3.1, 5.1 dhe 8.1 (vi). Në këto raste, përgatitjet për krijimin e procedurave apo politikave përkatëse duhet të evidentohen dhe duhet të lejojnë rishqyrtimin nga ana e autoritetit liçensues.

### **III. Kërkesat për Liçensim**

#### ***1. Dispozitat ligjore për liçensim***

1.1 Dispozitat ligjore që përcaktojnë liçensimin e insituteve të pensionit (dhe kur është e nevojshme edhe të planeve të pensionit) vendosen nga autoritetet përkatëse.

1.2 Gjithashtu vendosen edhe dispozitat ligjore në lidhje me tipin e planit të pensionit dhe/ose te fondit të pensioit që mund të krijohen dhe strukturën ligjore të instituteve të pensionit.

---

<sup>2</sup> Për shembull marrëveshjet dypalëshe të njohjes që përdoren në BE.

## ***2. Dokumentete e qeverisjes***

2.1 Planet dhe/ose institutet e pensionit duhet të kenë statute apo dokumente formale të shkruara që përshkruajnë qëllimin e planit/institutit ose parametrat e planit (si psh tipet e kontibuteve dhe përfitimeve), strukturën qeverisëse dhe dispozitat për kontraktimet ose shërbime nga palët e treta, dhe gjithashtu duhet të përcaktojnë edhe të drejtat e anëtarëve dhe përfituesve të tjerë.

## ***3. Menaxhimi i riskut, mekanizmat e raportimit dhe auditimit***

3.1 Insitutet e pensionit duhet të kenë mekanizma të përshtatshme të menaxhimit të riskut për të adresuar në këtë mënyrë risqet e investimit, të operimit dhe të qeverisjes, dhe gjithashtu duhet të kenë edhe mekanizma të përshtatshëm për raportimin e brendshëm dhe auditimitin.

3.2 Nëse institutet e pensionit administrojnë më shumë se një fond apo plan pensioni, atyre duhet t'u kërkohej që të mbajnë llogari dhe të dhëna të veçanta për çdo plan apo fond pensioni që ato menaxhojnë.

## ***4. Politikat financuese***

4.1 Institutet e pensionit që ofrojnë një përfitim të përcaktuar (PP) dhe plane hibride/të përziera duhet të kenë politika financuese që përcaktojnë burimin e fondeve, metodën aktuale që do të përdoret, dhe mekanizmat për të përmbushur kërkesat ligjore të financimit.

4.2 Në rastin kur një institut pensioni administron aktive për fonde dhe plane të ndryshme pensionesh, atëherë duhet të përgatiten politika dhe metoda financuese të veçanta për çdo plan apo fond pensioni.

## ***5. Politikat e investimeve***

5.1 Institutet e pensionit duhet të përgatisin raporte për politikat investuese.

5.2 Në rastin kur një institut pensioni administron fonde dhe plane të ndryshme pensionesh atëherë duhet të përgatiten raporte për politikat investuese të veçanta për çdo plan apo fond pensioni.

## ***6. Kërkesat për kapital***

6.1 Në rastin kur institutet e pensionit janë të ekspozuar direkt ndaj rreziqeve financiare apo demografike, ato kërkohej të mbajnë një shumë minimale të një kapitali fillestar të përdorshëm (të lirë) dhe të paangazhuar, ose të paktën të jenë të lirshëm të përdorin burime të përshtatshme financiare. Shuma në fjalë varet nga risku që duhet të mbulojë. Kapitali minimal që kërkohej nuk mund të përdoret për të mbuluar shpenzimet e krijimit të institutit. Në mënyrë që të sigurojë funksionin garantues të kapitalit minimal,

legjislacioni mund të kërkojë ruajtjen mënjane të disa aktiveve të caktuara. Në disa jurisdiksione kërkesat e kapitalit mund të plotësohen edhe nga blerja e siguracionit i cili ofron të njëjtin nivel mbrojtjeje për anëtarët dhe përfituesit e planit të pensionit.

## ***7. Qeverisja***

7.1 Institutet e pensionit kanë organizma qeverisës që janë përgjegjës deri në fund për institutin dhe për kodin e sjelljes të anëtarëve, të organizmit qeverisës dhe të stafit. Kodi i sjelljes mund të përcaktohet në akte ligjore të veçanta që do të zbatohen nga institutet e pensionit.

7.2 Anëtarët e organizmave qeverisës të institutit të pensionit duhet t'i nënshtrohen këkesave të principit "fit and proper".

7.3 Institutet e pensionit mund të këkohen të mbajnë ndarje funksionale ndërmjet stafit që është përgjegjës për investimet dhe atij përgjegjës për kryerjen e marrëveshjeve dhe kontabilitetin.

## ***8. Plan i biznesit***

8.1 Institutet e pensionit duhet të krijojnë një plan biznesi që duhet të paktën të përfshijë (i) një listë të planeve/fondeve që instituti i pensionit do të menaxhojë; (ii) tipet e detyrimeve që instituti i pensionit propozon të marrë përsipër (p.sh garancitë e kompensimit apo përfitimin), nëse ka; (iii) shpenzimet e llogaritura dhe mjetet financiare për themelimin; (iv) zhvillimet e projektuara të fondit/planit; (v) kur është e nevojshme, mjetet për të përmbushur kërkesat e kapitalit; dhe (vi) detaje mbi menaxhimin e duhur të riskut, mekanizmat e raportimit dhe auditimit, dhe politikat koherente të investimit që janë vendosur ose do të vendosen me hapjen e aktivitetit.

## ***9. Heqja e liçensës***

9.1 Dispozitat ligjore e kërkojnë, në disa rrethana të veçanta, heqjen e liçensës të një instituti pensioni.

9.2 Dispozitat ligjore lejojnë, që një instituti pensioni që i është hequr liçensa në mënyrë të detyrueshme, të ketë të drejtën për apelim të vendimit për arsye rishqyrtimi.

## **IV. Të drejtat dhe detyrimet e autoritet liçensues**

### ***10. Roli i autoritet liçensues në çështjet e mbikëqyrjes***

10.1 Dispozitat ligjore duhet të përcaktojnë rolin e autoritetit liçensues në një sistem më të gjërë mbikëqyrës dhe rregullator. Kur ka autoritete të veçanta liçensuese dhe mbikëqyrëse, atëherë duhet të lejohet që autoriteti mbikëqyrës të konsultohet në çdo aplikim për liçensë.

## ***11. Qartësia e procedurës të aplikimit për liçensë***

11.1 Dispozitat ligjore duhet të promovojnë një përcaktim të qartë të procedurës së aplikimit, duke përfshirë:

- informacione mbi detyrimet e autoritetit liçensues, psh aftin kohor brenda të cilit ai duhet të marrë vendimin mbi aplikimin;
- procedurat që duhet të ndjekë autoriteti liçensues për kërkimin e të dhënave të mëtejshme nga aplikuesi;
- veprimet që do të ndërmarrë autoriteti liçensues për të konfirmuar marrjen e informacionit si pjesë e aplikimit për liçensë;
- kërkesën që stafi i autoritetit liçensues të zbatojë standartet e duhura të konfidencialitetit përsa i përket të dhënave të mbledhura gjatë procesit të aplikimit për liçensë ( në përjashtim të të dhënave që duhet t'u jepen autoriteteve të tjera publike).

## ***12. Paraqitja e dokumenteve***

12.1 Autoriteti liçensues duhet të ketë të drejtën të kërkojë paraqitjen e dokumenteve të qeverisjes dhe dokumente të tjera të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë së institutit me kërkesat liçensuese të përshkruar në seksionin III.

## ***13. Vlerësimi i aplikimit për liçensë***

13.1 Autoriteti liçensues duhet të ketë të drejtën të:

- të ekzaminojë strukturën e propozuar ligjore, adminstruese dhe të pronësisë të aplikuesit apo grupit më të gjërë të tij (nëse ka);
- të vlerësojë drejtorët e propozuar dhe anëtarët e tjerë të organizmave qeverisës në lidhje me ekspertizën dhe integritetin e tyre, në lidhje me njohuritë, eksperiencën dhe precedentin penal të tyre.
- të rishikojë planet e propozuara strategjike dhe operuese të aplikuesit, duke përfshirë:
  - të përcaktojë nëse është vendosur në mënyrë të duhur një sistem qeverisjeje, menaxhim risku, kontroll i brendshëm dhe kod sjelljeje, dhe
  - të konsiderojë nëse struktura operuese e aplikuesit reflekton qëllimin dhe shkallën e sofistikimit të veprimtarive të propozuara nga aplikuesi;
- të rishikojë politikat dhe procedurat që aplikuesi ka/synon të vendosë për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme me detyrimet e tij sipas legjislacionit

- përkatës dhe me kushtet e liçensës dhe të kuadrit kontrollues për menaxhimin e riskut të krijuar nga vetë aplikuesi.
- të rishikojë preventivet financiare të aplikuesit dhe të vlerësojë forcën e tij financiare dhe burimet e tjera;
  - kur është e mundshme, të identifikojë dhe të përcaktojë përshtashmërinë e aksionerëve kryesorë, duke përfshirë pronarët kryesorë të përfitimit, dhe përshtashmërinë e personave të tjerë që mund të kenë një influencë të konsiderueshme mbi aplikuesin, dhe gjithashtu të vlerësojë transparencën e strukturës pronësore dhe burimet e kapitalit fillestar (nëse kërkohet).

13.2 Autoriteti liçensues duhet që, në rrethana të veçanta, të ketë fleksibilitet në aplikimin e kërkesave ligjore, në mënyrë që tipi, shkalla dhe kompleksiteti i veprimtarisë së aplikuesit të merret në konsideratë gjatë vlerësimit nëse ai i ka përmbushur kriteret e liçensimit apo mënyrën se si i ka përmbushur ato. Rrethanat kur autoriteti liçensues mund t'i aplikojë në mënyrë elastike kërkesat ligjore duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë në aktet ligjore dhe duhet të garantohet edhe mbrojtja ndaj veprimeve arbitrare nga ana e autoritetit liçensues.

13.3 Autoriteti liçensues mund të ketë kompotencën që t'i imponojë aplikuesit kushte për liçensim, dhe më pas t'i ndryshojë apo t'i tërheqë këto kushte. Rrethanat kur këto kushte do të imponohen, tërhiqen ose modifikohen do të përcaktohen qartë në aktet ligjore.

#### ***14. Materialet e udhëzimeve***

14.1 Autoritetet e liçensimit dhe të mbikëqyrjes mund t'u japin udhëzime aplikuesve në lidhje se si duhet t'i përmbushin kriteret e liçensimit, që të ketë rezultate më të mira në sistemet e brendshme (si p.sh sistemi i menaxhimit të riskut).

14.2 Autoriteti liçensues duhet t'u japë udhëzime të duhura të gjithë nëpunësve që merren me vlerësimin e liçensimit.

#### ***15. E drejta për refuzimin, modifikimin ose heqjen e liçencës***

15.1 Autoriteti liçensues duhet të ketë të drejtën e refuzimit të një aplikimi nëse kriteret nuk janë përmbushur ose informacioni i dhënë nuk është i saktë, duke mundësuar kështu që procesi i vlerësimit të mbrojtë qëllimin e sistemit të liçensimit. Çdo refuzim duhet të përfshijë identifikimin e kriterëve të caktuara mbi të cilat është mbështetur ky vendim.

15.2 Autoriteti liçensues duhet të ketë të drejtën të bëjë rregullime të një liçense që është dhënë ose ta heqë atë kur kriteret për marrjen e liçensës nuk po përmbushen në mënyrë të vazhdueshme edhe pas marrjes së saj. Këto kompetenca duhet të përcaktohen qartë në aktet ligjore.



15.3 Autoriteti liçensues duhet të ketë një mekanizëm rishqyrtimi për të ekzaminuar kërkesat e instituteve të cilëve u është modifikuar apo hequr liçensa.

15.4 Vendimet e autoritetit liçensues duhet të kenë mundësinë t'i nënshtrohen një apelimi adminstrativ dhe gjyqësor. Duhet të vendosen disa masa të përshtatshme për mbrojtjen në rast të veprimeve arbitrare nga ana e autoritetit liçensues.

## **SHËNIME TË UDHËZIMEVE PËR LIÇENSIMIN E INSTITUTEVE TË PENSIONIT**

### **III Kërkesat për liçensim**

#### ***1. Dispozitat ligjore mbi liçensimin***

1. Në interes të transparencës, të vërtetësisë ligjore dhe qëllimeve të përmendura në parathënise të këtyre udhëzimeve, rregullat e liçensimit përcaktohen me anë të legjislacionit. Dispozitat ligjore përcaktojnë strukturën e procesit të liçensimit dhe gjithashtu përcaktojnë kompetencat, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë të të gjitha palëve të përfshira në proces. Dispozitat ligjore përgjithësisht ndikojnë vetëm në institutet e pensionit, por në disa jurisdiksione ato aplikohen edhe nga planet e pensionit, veçanërisht kur çdo plan është i lidhur me një institut të vetëm pensioni.

2. Dispozitat ligjore përcaktojnë tipet e planeve apo fondeve të pensionit që mund të krijohen [psh plane me përfitime të përcaktuara (DB), të pëziera, hibride ose kontibute të përcaktuara (DC)] dhe strukturën ligjore të instituteve të pensionit (psh kujdestari, fondacion, organizatë jo-fitimprurëse, sh.a, sh.p.k).

#### ***2. Dokumentet e qeverisjes***

3. Dokumentet e qeverisjes së instituteve ose planeve të pensionit mund të pëmbajnë statutin, aktet e themelimit, aktin e kujdestarisë ose rregullat e planit të pensionit, në varësi të dispozitave ligjore përkatëse apo strukturës ligjore të institutit të pensionit.

4. Qëllimi i institutit të pensionit dhe i planit të biznesit duhet të jetë një burim i sigurtë i të ardhurave të pensionit.

5. Dokumentet e qeverisjes specifikojnë nëse garancitë e kompensimit apo përfitimit ose premtimet janë apo jo të kushtëzuara nga efektshmëria e fondit apo e planit. Në rastin e premtimeve të pakushtëzuara, është e nevojshme që dokumentet e qeverisjes të përcaktojnë nëse punëdhënësi sponsorizues dhe/ose anëtarët e planit mund të kërkojnë t'i rrisin kontributet e tyre në mënyrë që të rregullojnë balancën financiare të fondit apo planit.

6. Gjithashtu është e nevojshme që dokumentet e qeverisjes të përcaktojnë (i) strukturën ligjore të institutit të pensioneve, strukturën e kapitalit dhe qëllimin; (ii) kontributet dhe

përfitimet; (iii) mjetet që do të përdoren për sigurimin e ndarjes juridike ndërmjet aktiveve të planit/fondit të pensionit dhe shoqërisë të adminstrimit të pensionit dhe gjithashtu ndërmjet planeve/fondeve të tjera të adminstruara nga shoqëria; (iv) strukturën organizative; (v) strukturën qeverisëse, rolin dhe përgjegjësitë e organizmave qeverisëse; dhe (vi) kontratën e antarësise/binjakëzimit nëpërmejt të cilave instituti i pensionit lejon të adminstrohet nga një shoqëri tjetër.

### ***3. Menaxhimi i riskut, mekanizmat e raportimit dhe të auditimit***

7. Është e nevojshme që të vendosen masa për një auditimit të herëpashershëm dhe për raportim nga ana e audituesit, aktuarit (planet DB) dhe organizmave qeverisëse në mënyrë që të arrihet kështu një mbikëqyrje e përshtashme, që të arrihet transparencë dhe veprimtari koherente e shoqërisë.

8. Rregullat për pasqyrimin e informacionit rrisin transparencën e veprimtarive të organizmave qeverisëse, ashtu siç bën të njëjtën gjë edhe krijimi i procedurave organizative dhe adminstruese. Për arsye të përmendura më lart është e pëlqyeshme që çdo fond apo plan pension i adminstruar nga një institut pensioni, të ketë një llogari të veçanta.

9. Proçedura e menaxhimit të riskut kontribuon në veprimtari koherente të shoqërisë dhe gjithashtu ndihmon në krijimin e masave dhe sistemeve të duhura menaxhuese të riskut. Këto proçedura përfshijnë mekanizma që identifikojnë dhe adresojnë konfliktet e interesit dhe risqet e operimit, siç janë ato në lidhje me mosfunksionimin e teknologjisë. Gjithashtu nevojiten edhe disa mjete specifike për menaxhimin dhe vlerësimin e riskut të investimit dhe risqeve të tjera të lidhura me fondin apo planin e pensionit.

### ***4. Politikat financuese***

10. Politikat financuese përshkruajnë në detaj strategjinë që instituti i pensionit ndjek për t'u përputhur me nivelet e kërkuara të financimit të cilat janë vendosur nga rregullatori përkatës. Në rastin e planeve DB dhe planeve hibride/të përziera, politikat financuese bazohen në metodat dhe teknikat aktuale të miratuara.

11. Në interes të transparencës, është themelore që çdo fond apo plan pensioni i adminstruar nga një institut pensioni, t'i ketë të përcaktuara politikat dhe metodat e tij financuese.

### ***5. Politikat e investimit***

12. Politikat e investimit përcaktojnë qëllimet financiare të fondit apo të planit të pensionit. Gjithashtu, ato përcaktojnë parimet e investimit, shpërndarjen strategjike të aktiveve, realizimin e qëllimeve dhe synimet për menaxhimin e riskut, proçesin e zgjedhjes së adminstruesit të aktiveve, gjithashtu mekanizmat e monitorimit dhe rishqyrtimit të veprimtarisë dhe mekanizmat e ndryshimit të shpërndarjes së aktiveve dhe adminstruesve të tyre.

13. Paraqitja e politikave të investimit si pjesë e aplikimit për liçensim, lejon që autoriteti liçensues të bëjë vlerësimin nëse këto politika janë të përshtashme dhe nëse janë në të njëjtën linjë me qëllimet dhe përgjegjësitë e fondit dhe kërkesat përkatëse ligjore. Gjithashtu ajo lehtëson mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve investuese të institutive të pensionit pas liçensimit. Është veçanërisht e rëndësishme që politikat investuese të jenë në përputhshmëri me përgjegjësitë financiare të fondit apo planit të pensionit.

#### ***6. Kërkesat e kapitalit***

14. Në disa jurisdiksione të veçanta, institutet e pensionit duhet të kenë një shumë minimale të kapitalit fillestar. Në rastin kur ndodh kjo, shuma minimale e kapitalit fillestar varet nga llojet e risqeve të menaxhuara, nga shtrirja e përgjegjësisë së institutit të pensionit për çdo garanci kompensuese/përfituese ose nga keq-administrimi, dhe gjithashtu varet edhe nga madhësia e fondit që administrohet. Në këto jurisdiksione, autoriteti liçensues duhet të ketë prova që kërkesat e kapitalit janë përmbushur (në rastin kur këto kërkesa nuk janë adresuar nga mbikëqyrësi tjetër i institutit financiar).

#### ***7. Qeverisja***

15. Instituteve të pensionit normalisht ju kërkohet të paraqesin të dhëna mbi strukturën qeverisëse, si emrat, CV-të dhe të dhënat kontaktuese të anëtarëve të organizmave qeverisës/drejtues. Këto të dhëna duhet të përfshijnë gjithashtu çertifikatat profesionale dhe një deklaratë që konfirmon që personat nuk kanë precedent penal për krime financiare apo pronësie dhe nuk janë në proces gjykimi. Informacioni i kërkuar mund të përshihet në dokumente e mëposhtme, të cilat do të kërkohen të paraqiten nga instituti i pensionit:

- Statutet dhe dokumentet e planit apo institutit;
- Kodi i sjelljes i antarëve të organizmave të qeverisjes/drejtimit dhe të stafit plotësues, që adreson ndër të tjera edhe konfliktet e interesit dhe emërimet e ndaluara;
- Kontratat e shërbimit të palëve të treta;
- Të dhëna për menaxhimin e riskut, për mekanizmat e raportimit dhe të auditimit.

16. Për qëllime mbikëqyrjeje dhe në interes të transparencës, institutet e pensioneve mund të kërkohen të paraqesin një ose më shumë nga këto: të dhënat e kontaktit të sponsorit të planit, të aktuararit, të auditit të pavarur dhe të kujdestarit.

17. Në disa jurisdiksione, kërkesat për qeverisjen e shoqërisë mund të marrin trajtën e kufizimeve formale, në bazë të të cilave adminstruesi i planit apo fondit të pensionit është i ndaluar t'i ushtrojë kompetencat e tij që t'i adresojë investimet drejt palëve me të cilat ai ka lidhje. Në nota më të përgjithshme këto kërkesa reflektohen në ndalimin me ligj për të

marrë pjesë në ndonjë transaksion në lidhje me aktivet e planit apo të fondit të personave që janë, në një mënyrë apo tjetër, të lidhur me institutin e pensioneve.

18. Në mënyrë që të evitohen konfliktet e interesit, që të rritet transparencja dhe që të mbrohen interesat e anëtarëve të institutit të pensionit dhe të përfituesve është e pëlqyeshme një ndarje ndërmjet stafit që merret me investimet dhe atij përgjegjës për kryerjen e marrëveshjeve dhe kontabilitetin. Kjo ndarje do të reflektohet në strukturën organizative të institutit të pensionit.

19. Në rastet kur marrëveshjet kontraktuese bëhen të dukshme gjatë procedurës së liçensimit, ato do të qartësojnë në kontakt se çfarë detyrash do të ketë gjithësecili. Informacionet mbi marrëveshjet kontraktuese e lejojnë autoritetin të vlerësojë nëse aplikuesi nuk e kalon kufirin e kontraktimit, nuk e shkel detyrën për të monitoruar dhe për të mbikëqyruar siguruesin e shërbimit të jashtëm dhe që nuk e liron veten nga përgjegjësia e aktiviteteve të kontraktuara.

### ***8. Plani i biznesit***

20. Plani i biznesit përshkruan aktivitetin e propozuar të institutit të pensionit në vitet e para të tij pas krijimit. Projektet e zhvillimit të aktivitetit përfshijnë të dhëna mbi nivelin e kontributeve, aktivet nën administrim, pagesat e përfitimeve, dhe shpenzimet operative për çdo fond apo plan që do të menaxhohet, të dhëna mbi parametrat e numrit të parashikuar të anëtarëve të planit, të dhëna mbi grupin e shenjësuar (me çfarë të ardhurash, dhe çfarë profesioni, etj) dhe periudhën e menduar për të paguar mbrapsht kostot e themelimit që mund të përfshihet edhe në dokumentet në lidhje me zhvillimet e projektuara të planit apo të fondit.

### ***9. Heqja e liçensës***

21. Është e nevojshme që ligji të përcaktojë rrethanat sipas të cilave një liçensë mund të hiqet ose mund të konsiderohet si e tillë. Kjo duhet të ndodhë në situatat e mëtejshme: (i) kur instituti nuk i përmbush më kërkesat e liçensimit; (ii) kur shkel rëndë ligjin; (iii) kur instituti i pensioneve shprehimisht heq dorë nga liçenca; (iv) kur liçenca nuk përdoret brenda një periudhe të caktuar kohe; (v) kur nuk e ushtron më veprimtarinë; ose (vi) kur instituti i pensioneve e ka marrë liçensën në bazë të informatave të rreme. Në jurisdikSIONET ku liçenca mund të hiqet kur fondi i pensioneve nuk e përdor atë brenda një periudhe të caktuar kohore, atëherë ligji duhet ta përcaktojë qartë këtë periudhë.

22. Drejtësia e kërkon që të ekzistojnë mekanizma ligjore korrigjuese në rastin kur instituteve të pensionit ju është hequr liçensa në mënyrë të detyrueshme.

## **IV Kompetencat dhe detyrimet e autoritetit liçensues**

### ***10. Roli i autoritetit liçensues në çështjet mbikëqyrese***

23. Këto udhëzime theksojnë rëndësinë e lidhjes ndërmjet liçensimit të insituteve të pensionit dhe mbikëqyrjen e tyre të vazhdueshme, sepse të dyja janë të rëndësishme për të arritur qëllimet e përmenduar në fillim të këtyre udhëzimeve. Në pjesën më të madhe të rasteve, autoriteti liçensues dhe ai mbikëqyrës është një institucion i vetëm, duke siguruar kështu një përputhshmëri ndërmjet kërkesave dhe rregullave të liçensimit dhe qëllimeve për mbikëqyrjen e vazhdueshme. Megjthatë, kur ato janë dy institucione të ndryshme, këshillimi i mbikëqyrësit për aplikimin e liçensës kontribuon në përputhshmërinë e praktikës së liçensimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme.

### ***11. Qartësia e procedurës së aplikimit për liçensë***

24. Në interesin e aplikuesve dhe autoriteteve liçensuese, dhe në mënyrë që të sigurohet një proces liçensimi sa më praktik, është e nevojshme që ligji të përcaktojë hapat e ndryshëm në procesin e liçensimit dhe të përcaktojë kompetencat e autoritetit liçensues. Këto kompetenca mund të përshijnë një rishikim të dokumenteve dhe inspektim në terren para ose mbrapa liçensimit. Githashtu, duhet të përcaktohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit liçensues dhe të aplikuesit për liçensë.

25. Hapat e procesit të aplikimit, të cilat duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë, përfshijnë fillimisht të dhënat dhe dokumentet që autoriteti liçensues kërkon nga aplikuesi. Hapa të tjera që duhen përcaktuar përfshijnë ato nëse autoriteti mundet apo jo, të kërkojë të dhëna të tjera shtesë ose të kërkojë korrigjimin e aplikimeve të mangëta dhe të përcaktojë kohën brenda së cilës aplikuesi duhet të përgjigjet këtyre kërkesave. Gjithashtu është e nevojshme për aplikuesin të dijë se çfarë lloj vendimesh mund të marrë autoriteti liçensues, cilat dokumente do të rishqyrtohen, nëse do të ketë inspektim në terren dhe deri në çfarë mase autoriteti liçensues mund të kryejë kontrolle me autoritete të tjera publike duke pasur gjithmonë si qëllim aplikimin për liçensë. Përfundimisht aplikuesi duhet të dijë se si do t'i njoftohet vendimi i autoritetit liçensues dhe të njohë procesin e apelimit nëse aplikuesi ndihet i pakënaqur nga vendimi.

### ***12. Paraqitja e dokumenteve***

26. Në mënyrë që autoriteti të vlerësojë nëse instituti i pensionit i përmbush kriteret e liçensimit dhe në mënyrë që të lehtësojë mbikëqyrjen në terren, insituti duhet të paraqesë të dhëna me shkrim për kërkesat e përmendura në seksionin III. Këto të dhëna përfshijnë dokumentet e qeverisjes, dokumentet që vërtetojnë që instituti i përmbush kërkesat për kapital (nëse ka), strukturën e qeverisjes, mekanizmat e menaxhimit të riskut dhe mekanizmat e raportimit dhe auditimit. Mekanizmat e auditimit, nëse nuk kërkohen përpara dhëniës së lejes për ushtrimin e biznesit, duhet të krijohen dhe të zhvillohen në një fazë me të vonë. Dokumente të tjera që duhen paraqitur përfshijnë dokumente që përcaktojnë politikat financuese, politikat e investimit, kërkesat për kapital (nëse ka) dhe planin e biznesit.

### ***13. Vlerësimi i aplikimit për liçensë***

27. Meqë qëllimi i vlerësimit të liçensimit ndryshon sipas rasteve, është e rëndësishme që autoriteti liçensues të ketë të drejtën të vlerësojë aspekte të ndryshme të institutit të pensioneve. Këto të drejta duhet të përcaktohen qartë në legjislacion. Intensiteti i vlerësimit të liçensimit mund të varet nga përmasat dhe kompleksiteti i veprimtarisë së institutit. Qëllimi i këtyre kompetencave jo vetëm që duhet të jetë i përcaktuar qartë aktet ligjore përkatës, por gjithashtu duhet të këkohet që këto kompetenca të ushtrohen duke trajtuar të gjitha palët në mënyrë të njëjtë dhe në përputhje me ligjin, duke ndjekur kështu jo vetëm procedura që janë transparente, por edhe praktika të mirë-vendosura dhe transparente. Këto praktika do të aplikohen edhe në shënimet e udhëzimit IV.15 (“Kompetencat për të refuzuar, modifikuar ose hequr liçensën”).

28. Autoriteti liçensues mund të ketë nevojë që të vlerësojë ekspertizën dhe integritetin e drejtorëve të institutit të pensioneve dhe adminstruesve të lartë. Me anën e provës të principit për “fit and proper”, përfshirë këtu edhe konfliktet e mundshme të interesit, duke vlerësuar aftësitë dhe eksperiencën në veprimtaritë e caktuara financiare që korrespondojnë edhe me aktivitetin që do të ushtrojë aplikuesi. Gjithashtu, autoriteti duhet të kërkojë vërtetim që nuk ka precedentë penal për aktivitete të paligjishme apo që nuk janë marrë vendime gjyqësore korrektive ndaj individëve që do të kenë poste të rëndësishme në institutin e pensionit të aplikuesit në fjalë, gjë që do i kishte bërë këto individë të papërshtatshëm për të mbajtur pozicione të tilla.

29. Autoriteti liçensues, kur është e përshtatshme, mund të ketë nevojë që të vlerësojë përshtatshmërinë e aksionerëve të institutit të pensionit në të njëjtën mënyrë si vlerëson edhe drejtorët dhe adminstruesit e lartë të institutit.

30. Normalisht autoriteti liçensues, në mbështetje të planit strategjik të propozuar, duhet të ketë edhe kompetencën për të vlerësuar forcën financiare të aplikuesit (përfshirë këtu edhe nëse janë përmbushur kërkesat e detyrueshme për kapital), për të vlerësuar se sa të përshtatshme janë politikat financiare sëbashku me teknikat dhe metodat e aktuaristikës, dhe për të vlerësuar strukturën operative dhe atë të qeverisjes.

31. Vlerësimi mund të përfshijë edhe një ekzaminim të mekanizmave në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve të paligjishme të kryera nga kushdo brenda institutit të pensionit, dhe gjithashtu edhe të mekanizmave në lidhje me papërgjegjshmërinë e funksioneve të propozuara kontraktuese.

32. Në jurisdiksionet ku autoriteti i liçensimit mund të imponojë kushte mbi aplikuesin e liçensës, kompetencat dhe kufizimet për t'i imponuar këto kushte duhet të përcaktohen me ligj, në mënyrë që të sigurohet transparencë, drejtësi dhe vërtetësi ligjore në procesin e liçensimit. Kushtet mund të imponohen, të modifikohen ose të hiqen pas një kërkesë nga ana e aplikuesit për liçensim ose nga ana e vetë autoritetit liçensues (nëse është e nevojshme në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës në rastin kur ato janë dy institucione më vete).

#### ***14. Materialet udhëzuese***

33. Proçesi i aplikimit për liçensë në shumë vende përfshin paraqitjen dhe analizimin e të dhënave komplekse. Për këtë është e nevojshme që të përgatiten materiale udhëzuese për vlerësuesin e liçensimit i cili punon për autoritetin liçensues dhe gjithashtu edhe për aplikuesin. Këto materiale shkurtojnë kohën që duhet për të vlerësuar një aplikim për liçensë dhe lehtësojnë punën e vlerësuesit. Materialet udhëzuese më ndihmuese për vlerësuesin janë listat e detyrave dhe manualët, ose një grup procedurash për inspektimet në terren dhe jo vetëm.

34. Në të njëjtën mënyrë, proçesi i liçensimit mund të bëhet më i lehtë për aplikuesin nëse edhe atij do t'i jepeshin materiale udhëzuese. Materiale të vlefshme në këtë rast mund të jenë një listë me të gjitha kërkesat që ato duhet të plotësojnë, formën e aplikimit dhe materialin shpjegues bashkëngjitur, dhe gjithashtu materilin shpjegues se si aplikuesi duhet t'i përmbush kriteret e liçensimit.

### ***15. Kompetencat për të refuzuar, modifikuar ose tërhequr liçensën***

35. Proçesi i liçensimit është më efektiv nëse autoriteti liçensues ka të drejtën për të refuzuar aplikimin për liçensim në rastin kur aplikuesi nuk i përmbush të gjitha kriteret që i kërkohen. Është e rëndësishme që autoriteti liçensues të mos ushtrojë të drejtën e tij të vetgjyqimit duke marrë vendime të pa baza, por të mbështet në përmbushjen e kërkesave ligjore. E drejta për të refuzuar aplikimin për liçensë duhet të ushtrohet në përputhje me praktikën transparente, të cilat i bëhen të ditura paraprakisht institutit që po aplikon për liçensë. Transparenca gjithashtu kërkohet edhe në vendimet për refuzim dhe praktikën duhet të jenë në përputhje me ligjin. Qëllimi i vetgjyqimit që mund të ushtrohet nga autoriteti liçensues duhet të parandalohet apo limitohet sa më shumë që të jetë e mundur.

36. Në mënyrë që të arrihet një proçes transparent dhe i drejtë, është e nevojshme që autoriteti liçensues ta informojë saktësisht aplikuesin për arsyen që çuan në vendimin për refuzimin e liçensës.

37. Në sistemin liçensues ku autoriteti ka të drejtën të imponojë kushte në përdorimin e liçensës, normalisht ai duhet të ketë edhe kompetencën për t'i modifikuar këto kushte nëse e kërkon situata.

38. Autoriteti liçensues gjithashtu ka edhe të drejtën që të heqë liçensën, por vetëm në rrethana të veçanta që janë specifikuar qartë nga ligji. (shiko udhëzimin 9 për heqjen e liçensës).

39. Autoriteti liçensues duhet që ta informojë në mënyrë të qartë dhe në kohë institutin e pensionit për arsyet e sakta që çuan në marrjen e vendimit për heqjen e liçensës.

40. Instituteve të pensionit që ju është hequr apo modifikuar liçensa duhet të jetë e mundur që të rishikohet vendimi për heqjen apo modifikimin e liçensës (apelimi administrativ) ose të shqyrtohet nga gjykata (apelimi gjyqësor). Mekanizmi i rishqyrtimit duhet të jetë transparent dhe duhet të përfshijë masa të duhura mbrojtëse për modifikimi

dhe veçanërisht për heqjen e autorizimit ose humbjes së përfitimeve tatimore. Duhet të kushtohet kujdes që kjo heqje apo humbje e sipërpërmendur të most të ndodhë përpara mbarimit të mekanizmit të rishqyrtimit, në përjashtim të rasteve kur vonesa do të rezultonte në dëme të pandreqshme, veçanërisht kundrejt anëtarëve të planit të pensionit. Mekanizmat e rishqyrtimit duhet të evitojnë procedura dhe kërkesa që nuk duhet të jenë domosdoshmërisht të kushtueshme dhe të ngarkuara (përsëri, kushtëzohet nga masat e duhura mbrojtëse për anëtarët e planit).

41. Mundësia për të nisur një proces apelimi gjyqësor apo administrativ i nxit autoritetet liçensuese që të marrin vendime që i rezistojnë shqyrtimeve juridike, ndërsa nga ana tjetër i japin mundësi instituteve të pensionit të shprehin pakënaqësinë e tyre dhe që të sigurohen që vendimet e marra janë të drejta.

*Këto udhëzime, të përgatitura nga Komiteti i Sigurimeve dhe Pensioneve Private të OECD dhe Grupi i Punës për Pensionet Private dhe IOPS, janë miratuar nga Këshilli i OECD në Mars 2008.*